

02.02.2022
Ora 16:00

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|-------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja |
| Parti | Politike: | PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj) |
| OJQ: | | KRIK |

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar për ditën e sotme, datë 2 Shkurt 2022. Njoftimi për mbledhjen është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, së bashku me rendin e ditës. U është njoftuar gjithashtu partive politike dhe përfaqësuesve të tyre. Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme, kemi shqyrtimin e dy projektvendimeve. I pari “Për miratimin e rregullave proceduriale, për procesin e votimit dhe numërimit elektronik, nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit PEVN” dhe projektvendimi i dytë “Për përcaktimin e orarit të

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2022*

votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar bashkie, të datës 06 Mars 2022”. Kolegë dhe përfaqësues të partive politike të pranishëm, ndonjë çështje jashtë rendit të ditës? Faleminderit! Sipas radhës do të duhet të fillojmë me projektvendimin e parë, por para pak, nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet *e-maili*-t zyrtar, jemi njoftuar për tërheqjen e këtij projektvendimi. Do t’i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, të na bënte prezent, arsyet e tërheqjes së projektvendimit.

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të nenit 19, pika 1, shkronja “c”, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator, shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për rregullat proceduriale, për procesin e votimit dhe të numërimit elektronik, nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit PEVN, në qendrat e votimit të zonës zgjedhore nr. 26, Bashkia Vorë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 06 Mars 2022”. Nëpërmjet kësaj kërkesë, në zbatim të kompetencave të tij, Komisioneri kërkon tërheqjen nga propozimi i mësipërm, me qëllim përpunimin tërësor të projektvendimit, për ta risjellë në një moment të dytë të konceptuar si një akt të ri normues, për të gjitha llojet e zgjedhjeve, të përgjithshme për Kuvend, zgjedhjet vendore, zgjedhjet e parakohshme dhe zgjedhjet e pjesshme. Kjo është arsyeja pse ka kërkuar tërheqjen e aktit, faleminderit!

Znj. I. Nano: Në rregull, faleminderit! Pra, për ta ripunuar, për të sjellë një akt të ri normues, që të jetë i vlefshëm për të gjitha llojet e zgjedhjeve, jo vetëm për zgjedhjet e pjesshme që kemi tashmë në proces. Në fakt, ne për zgjedhjet e 25 prillit, për zgjedhjet për Kuvend të vitit të kaluar, ne kemi miratuar një vendim të tillë, të posaçëm për ato zgjedhje. Duke patur parasysh që ato rregulla u miratuan dhe u zbatuan në kuadër të një projekti pilot. Sigurisht duke lënë pastaj

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2022*

Komisionerin, për të vlerësuar zonën zgjedhore, apo zonën e administrimit zgjedhor, për t'u implementuar. Kanë kolegët ndonjë pyetje tjetër për administratën? Përfaqësuesit e partive politike? Zoti Logu, po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zonja Nano! Në fakt, sigurisht që e mirëkuptoj kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, por mendoj që duke qenë se edhe në këto zgjedhje, votimi elektronik dhe numërimi do të kryhet vetëm në një zonë zgjedhore, mendoj që do ishte e udhës që ndoshta dhe në këto zgjedhje, të vazhdohet me një vendim që përcakton, po themi, rregulla vetëm për këtë zonë zgjedhore. Më pas bashkërisht, ndoshta nëpërmjet një konsultimi paksa më të gjerë edhe me partitë politike dhe palë të tjera të interesuara, për procedura me një vendim që rregullon, procesin e votimit dhe numërimin elektronik në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ne sigurisht e mbështesim dhe shpresojmë shumë që të realizohet që në zgjedhjet vendore të vitit 2023.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zoti Kaziaj? Në rregull! Do t'i lutesha administratës që dhe këtë propozim të përfaqësuesit të partisë politike, zotit Logu, t'ia përcjellin Komisionerit. Kështuqë kolegë, jemi në kushtet që një nga aktet u tërhoq nga Komisioneri, që do të thotë nuk kemi një akt për ta diskutuar. Kështu që, kalojmë në aktin e dytë, "Për caktimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 06 Mars 2022". Në fakt, orari i zgjedhjeve është i përcaktuar në Kodin Zgjedhor, por duke patur parasysh zgjedhjet që zhvillohen në periudhat zgjedhore, njëra nga 15 prilli deri në 15 maj dhe tjetra nga 15 tetori deri në 15 nëntor. Duke qenë që jemi jashtë këtyre periudhave zgjedhore, për shkak se këto janë zgjedhje të pjesshme, ka ardhur një projektvendim për të përcaktuar ne si Komision Rregullator, pra si

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2022*

organi që miraton aktet normative në zbatim të Kodit Zgjedhor, përcaktimi i orarit. Zoti Merkaj!


Z. Y. Merkaj: Ne kemi parashikuar ose propozuar Komisionit Rregullator që ky afat ose orar të jetë ora 7:00 e mëngjesit deri në orën 19:00 të darkës, duke qenë se është më afër periudhës zgjedhore të përcaktuar nga neni 11, që është më afër datës 15 prill, që është dhe fillimi i periudhës zgjedhore, të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Duke qenë se është data 6 mars, mendojmë që dita ka filluar t'i marrë natës dhe ora 19:00, do të jetë ditë.

Znj. I. Nano: Pra, duke qenë që është më afër periudhës zgjedhore të pranverës, 15 prill-15 maj, sigurisht që do duhej të normohej. Mes dy orareve që janë ora 07:00 e mëngjesit deri 18:00 e mbrëmjes, apo 07:00 e mëngjesit deri 19:00 e mbrëmjes është propozuar ky orar, i cili me sa duket do të afektojë edhe aktet e tjera, qoftë për KZAZ-në, qoftë për qendrat e votimit. Kuptohet nëse ne do të miratojmë këtë orar, patjetër do të aktivizohen edhe detyrime të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor. Si ato që lidhen me vijimin e votimit, nëse në përfundim të orarit vijon të ketë zgjedhës pranë qendrës së votimit. Atëherë, kolegë dhe përfaqësues të partive politike, kemi diçka në parim për aktin? Po, zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zonja Nano! Ne në fakt kemi pasur mundësi të bëjmë dhe një konsultim paraprak me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe jemi dakord me logjikën e ndjekur. Edhe për shkak se përgjithësisht ka pasur një traditë, sa i përket orarit zyrtar të hapjes dhe mbylljes së votimit, që është ora 07:00 e mëngjesit dhe ora 19:00 e darkës, kështu që e gjejmë si orar të përshtatshëm për të dyja arsyet, faleminderit!

Znj. I. Nano: Zoti Kaziaj?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2022*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po faleminderit! Edhe ne e gjejmë të përshtatshëm dhe në përputhje me ato që janë parashikimet e Kodit Zgjedhor. Mbetet për t'u parë pjesa, në qoftë se do jetë natë apo ditë, sipas parashikimit astrologjik, të Sekretarit të Përgjithshëm.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Kolegë diçka në parim lidhur me aktin? Kalojmë në votimin në parim të projektaktit, "Për përcaktimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022".

Kush është dakord me projektaktin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!


Pika 1. Qendrat e votimit ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më 06 Mars 2022. Hapen në ora 07:00 dhe mbyllen në ora 19:00. Personalisht do të kërkoja nga administrata një riformulim të nenit, thjesht për të qenë më saktë. Zonja Vukaj, po!

Znj. H. Vukaj: Meqenëse përsëritet folja në të ardhmen "do të zhvillohet, do të zhvillohet" do sugjerim që të ketë një riparim ose një korrigjim.

Znj. I. Nano: Po patjetër, zonja Koja, urdhëroni!

Znj. M. Koja: Atëherë është riformuluar në këtë mënyrë "qendrat e votimit ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datën 6 mars, hapen në orën 07:00 dhe mbyllen në orën 19:00".

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2022*

Znj. I. Nano: Ka vetëm një problematikë, që ka dy folje të njëjta në të njëjtën fjali. Thjesht është riformulim nga këndvështrimi gjuhësor. Nëse nuk ka propozim, kalojmë në votim. Kjo është çështje që rregullohet gjuhësisht gjatë zbardhjes. Kalojmë në votimin e pikës 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

~~Kalojmë me votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë, dakordësinë tuaj, ose jo lidhur me projektvendimin.~~

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.02.02.2022*

Atëherë edhe publikisht, për të gjithë subjektet e interesuara, përfshirë dhe zgjedhësit në këto bashki, por dhe për administratën zgjedhore, subjektet zgjedhore në datën 6 mars, në 6 bashkitë ku do të zhvillohen zgjedhjet, qendrat e votimit hapen në orën 07:00 të mëngjesit dhe mbyllen në orën 19:00 të mbrëmjes. Duke qenë që nuk kemi një çështje tjetër për diskutim në rendin e ditës, mbledhjen e deklarojmë të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 12

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

